# DËSHMI ARKIVI

**A-463382**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “SPAK u nxitua me arrestin”, eksperti i sigurisë: Prokuroria e Posaçme duhej të vepronte ndryshe me kreun e SHISH |
| ADRESA | `https://lajmifundit.al/spak-u-nxitua-me-arrestin-eksperti-i-sigurise-prokuroria-e-posacme-duhej-te-vepronte-ndryshe-me-kreun-e-shish-i1338458` |
| BURIMI | lajmifundit.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:59:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 19:22:22 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `99db6bab22bd41f563e62550534f76df0d6eaa5cf8169d13fcc78a4cadd29c8e` |
| TEKSTI | `5807eca818bcfc870cf30fa8730e79941d5817e92be808e5988b9598d560d28c` |
| PAMJA | `920f3762e15ac12f400b5729297c15a34f1f3659039815a3363a9f9aa71ec32d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7172cf713bdc72b774efddcd13ea814aa4924ff516ede25ef135a332b2cc43a1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7172cf713bdc72b774efddcd13ea814aa4924ff516ede25ef135a332b2cc43a1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Tabela e rezultateve", loja e rrezikshme që po përhapet në rrjete sociale mes të rinjve Lexo lajmin e plote →

Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga "kokat" e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës Lexo lajmin e plote →

Familjet e ish-krerëve të UÇK-së refuzojnë takimin me Haxhiun pa ndryshuar ligji për Specialen Lexo lajmin e plote →

Giorgia Meloni kritikon ashpër Izraelin në OKB: "Keni kaluar vijën e kuqe, kryet masakër ndaj civilëve në Gaza"! Lexo lajmin e plote →

116 ditë qëndresë/ Protestuesit me mesazhe të forta për qeverinë dhe SHISH-in (FOTO) Lexo lajmin e plote →

# "SPAK u nxitua me arrestin", eksperti i sigurisë: Prokuroria e Posaçme duhej të vepronte ndryshe me kreun e SHISH

LAJMIFUNDIT / 23 SEPTEMBER 2026, 19:22 Shperndaje

AKTUALITET




Vlora Hyseni, e cila prej më shumë se 3 vitesh ishte në krye të Shërbimit Informativ Shtetëror, u vu nën masë sigurie nga Gjykata e Posaçme, e dyshuar për 2 vepra penale, atë të përkrahjes së autorit të krimit dhe zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete.

Hetimi është pjesë e një procedimi të nisur më herët dhe masat ndaj Hysenit u bënë publike ndërsa ajo ndodhej në Baku, në një vizitë pune. Por për ekspertët e sigurisë, SPAK duhej të gjente një mënyrë tjetër institucionale për të garantuar njëkohësisht hetimin dhe mbrojtjen e reputacionit të shërbimit.

"Nuk do isha dakord për një mënyrë veprimi të tillë për sa i përket reputacionit të shërbimit. Janë probleme të mprehta. Një mënyrë tjetër zgjidhjeje do të ishte t'i kërkohej dorëheqja. Pavarësisht situatës, kjo ngjarje nuk e eklipson punën e shërbimit. Vlora Hyseni, në krye të këtij shërbimi, ka marrë vlerësime nga ndërkombëtarët", tha eksperti i çështjeve të sigurisë Xhavit Shala.

Akuzat për nxjerrje të të dhënave sekrete janë veçanërisht sensitive. Por deri në këtë fazë bëhet fjalë për dyshime të hetimit dhe jo për një konstatim përfundimtar fajësie. Për këtë arsye, sipas ekspertit të sigurisë, nuk duhet bërë automatikisht një lidhje mes hetimit ndaj drejtueses dhe funksionimit të gjithë shërbimit.

"Nuk mendoj se janë shitur informacione që cenojnë sigurinë kombëtare. Jo për ta thjeshtëzuar, por mendoj se është një përzierje mes raporteve personale dhe emocionale me funksionin", tha eksperti i çështjeve të sigurisë Xhavit Shala.

Ndërkohë, ekspozimi i një drejtuesi të SHISH nën një masë sigurie për akuza që përfshijnë edhe

MOTI NE TIRANE
Tirana, Albania

POLITIKË
"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..." / Aktivistja i zë pritë deputetes së PS në zyrat e Kuvendit, kërcet debati (VIDEO)

POLITIKË
"Pse u hoq dëshmia e penalitetit dhe për kë?": Deputetja e PS, Koçeku, ngre pikëpyetje për Universitetin e Shkodrës

TRENDING

8,500 dëshmi konkrete të mbështetjes financiare nga sigurimi shëndetësor në SIGAL

One Albania sjell inovacionin Wi-Fi 7 për internetin në shtëpi

sekretin shtetëror sjell në mënyrë të pashmangshme një tjetër nevojë: qartësimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe garantimin se mekanizmat e sigurisë vazhdojnë të funksionojnë pa cenuar besimin reciprok.

## LEXONI GJITHASHTU



**"Po tallen me ne"/ Debate në Dhomën e Avokatisë, vendoset bojkot edhe për masat e sigurisë në GJKKO**



**Kur sekretet e shtetit përfundojnë në krevatin e biznesmenit**



**16 vite nga zhdukja e Bleona Matës, për herë të parë reagon SPAK**

"Ka nevojë për një hetim të brendshëm të institucionit dhe të sqarohen partnerët, është shumë e rëndësishme që partnerët të mbeten të sqaruar. Jemi anëtarë të NATO-s", tha eksperti i çështjeve të sigurisë Xhavit Shala.

Tashmë hetimi do të sqarojë përgjegjësitë konkrete të Vlora Hysenit dhe sidomos urgjencën për masën e arrestit shtëpiak. Ndërsa SHISH të vijojë funksionimin e tij dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë me një drejtues të ri të komanduar.


POLITIKË

**"Bela me Taon janë shokë, do bëhet kryetar Kuvendi", zbardhen SMS-të mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit në dosjen e SPAK**

POLITIKË

**"Territorialja", përplasje te ligjet, demokratët braktisin mbledhjen, PS vijon e vetme punën**

## ME TE LEXUARAT

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...

Lexo lajmin e plote

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

Lexo lajmin e plote

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!...

Lexo lajmin e plote

## ME TE LEXUARAT

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e Gjovalin Lazrit

Lexo lajmin e plote


## NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

Kliko për më shumë informacion



Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
Lexo lajmin e plote

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!
Lexo lajmin e plote

"Askush nuk është mbi ligjin"/ Rama shkarkon menjëherë Vlora Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH
Lexo lajmin e plote

Sekuestrohet hoteli "Central Park Premium" në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket
Lexo lajmin e plote

"Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot"/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap
Lexo lajmin e plote

LAJMI FUNDIT

KUSH JEMI | KONTAKT REDAKSINË | TE DHENAT PERSONALE | COOKIES

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by Mediadesk

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do te merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.